

Akti i Themelimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Selia, Regjimi Juridik

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 04/05/2023, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **Di.V.in.A SH.P.K.**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- **Olsi Molla**, i datelindjes 09.06.1986, i biri i Fatmir dhe Vjollca, banues ne adresen Rruga "Taulantia" Durrës, Shqipëri, i indentifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr: CA36633HN, me nr. Personal: **I60609073M**, qe ne vijim quhet Ortaku A.

- **Lorenzo Crotti**, i datelindjes 26.07.1969, i biri i Rodolfo dhe Giovanna , banues ne adresen Via Vincenzo Bellini 13, Monza, i indentifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr: CA81501AE, me nr. Personal: **CRTLNZ69L26F704M**, qe ne vijim do te quhet ortak B.

- **Michelangelo Achenza**, i datelindjes 17.06.1998, i biri i Salvatore dhe Vjollca, banues ne adresen Via Lessona Michele 48 Milano, Itali, i indentifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr: CA51118HN, me nr. Personal: **CHNMHL98H17F205D**, qe ne vijim do te quhet Oraku C.

- **Danjel Deda**, i datelindjes 03.11.1989, i biri i Viktor dhe Valentina, banues ne adresen Via Cavour 74 Novate Milanese, Itali, i indentifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr: AY9620182, me nr. Personal: **DDEDJL89S03Z100X**, qe ne vijim do te quhet ortak D.

- **Kunibert Nikolaus Welter**, i datelindjes 03.07.1963, i biri i Kunibert dhe Regina, banues ne adresen Kruterberg 14, 54439 Saarburg, Gjermani mbajtes i pasaportes me nr: **C2YVV08YN**, qe ne vijim do te quhet ortak E.

- **Massimiliano Giuseppe Giovanni Kerstich**, i datelindjes 16.01.1968, i biri i Claudio dhe Elisabetta, banues ne adresen Via Bono Cairoli Adelaide 17 Milano, Itali i indentifikuar nga leternjoftimi elektornik me nr: CA27341HE, me nr. Personal: KRSMSM68A16Z133M, qe ne vijim do te quhet Ortaku F.

Neni 2:

Objekti

Objekti i shoqerise eshte tregtia, edhe ne forme elektronike, e produkteve ushqimore dhe pijeve, perfshire pijet alkoolike, e pasurive te prekshme dhe jomateriale te lidhura me to, si p.sh.,

mobijle, kontejnere, aksesore, veshje dhe cdo gje tjeter qe eshte e pershtatshme. për mbështetjen, reklamimin, komercializimin dhe përmbajtjen e produkteve të mësipërme, në të gjithë territorin kombëtar dhe jashtë saj, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive të investuara, përfshirë edhe ato të huaja; ajo që paraprin ishte në vetvete ajo për llogari të së tretës;

- të ofrojë shërbime turistike që synojnë promovimin e territoreve në të cilat ndodhet shoqëria ose shoqëritë që prodhojnë mallrat e mbuluara nga aktivitetet e mësipërme;

- të ofrojë shërbime konsulence, tregtare dhe të tjera, në lidhje me mallrat që mbulohen nga aktivitetet e mësipërme;

- veprimtarinë e barit, kafeterisë, restorantit dhe kateringut, administrimin e ushqimeve dhe pijeve, shitjen e produkteve ushqimore dhe dietike.

Shoqëria mund të marrë dhe të japë mandate, përfaqësime dhe agjenci në çdo rast të dobishme për arritjen e qëllimit të korporatës.

Me qëllimin e vetëm të arritjes së qëllimit të korporatës (dhe në çdo rast jo në mënyrë profesionale ose kryesisht ndaj publikut) shoqëria mund të kryejë edhe transaksione tregtare, të letrave me vlerë, të pasurive të paluajtshme dhe industriale.

Neni 3:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Taulantia, ZK 8512 Durres, me numer pasurie 24/657/ND+2-42.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

info@divinahub.com

Neni 4:

Regjimi Juridik

(1) Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

(2) Me vendim te Ortakut te vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

(3) Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren

Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

(4).Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1.000.000,00 Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Beufca
Grati Erenis Motte
Albi Nelli
Michalangelo Lomanza

1. Ortaku themelues **Olsi Molla** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 230.000,00 leke që përben 23% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2.Ortaku themelues **Lorenzo Crotti** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 300.000,00 leke që përben 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 3.Ortaku themelues **Michelangelo Achenza** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 170.000,00 leke që përben 17% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 4.Ortaku themelues **Danjel Deda**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 150.000,00 leke që përben 15% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.Ortaku themelues **Kunibert Nikolaus Welter**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000,00 leke që përben 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
6. Ortaku themelues **Massimiliano Giuseppe Giovanni Kerstich**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000,00 leke që përben 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Ortaku që synon të shesë kuotat e tij, duhet të njoftojë shoqërinë dhe ortakët e tjerë, me shkrim ose me email të vërtetuar, për qëllimin e tij për të shitur kuotat e tij ose një pjesë të tyre, duke specifikuar shumën dhe mënyrën e pagesës. Ortaket dhe shoqëria kanë të drejtën e ofertes së parë në një vlerë të barabartë me 80% të shumës së propozuar nga ortaku që dëshiron të shesë kuotat. Kjo e drejtë parblerjeje duhet të ushtrohet brenda 30 ditëve nga momenti kur Ortaku që dëshiron të shesë kuotat ka njoftuar shoqërinë dhe ortakët për qëllimin e tyre për të transferuar kuotat. Pasi të kalojë ky afat, ortaku që dëshiron të shesë kuotat do të jetë i lirë të jetë në gjendje të shesë keto kuota tek ofertuesi më i mirë.

Raport

[Signature]

Michelangelo Achenza

Crotti Lorenzo Matteo

Olsi Molla

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Raport

[Signature]

[Signature]

Nicholas Homena

Crothi Eranis Motte

Olvi Nolle

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përgjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Raufa

[Signature]

[Signature]

Nikolaos Lomenis

Crothi Eranis Motter

Adri Rolli

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohen si Administratori i vetëm i shoqërise.

Të dhënat e identifikimit:

Olsi Molla, i datelindjes 09.06.1986, i biri i Fatmir dhe Vjollca, banues ne adresen Via Val Trompia 84, Milano, Itali, i indentifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr: CA36633HN, me nr. Personal: **MLLSO86H09Z100D**

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratores jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Croati Examinator

Olsi Molla

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Bayden

Michalangelo Llanusa

Dr

Ullat

Croati Eranis Mottos

Oliveri Nolle

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë që i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K E T

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Di.V.in.A SH.P.K.


Emer mbiemer

(nenshkrimi)


KUNIBERT NIKOLAUS



OLSI DORCA



MICHAELANGELO ALEXANDRA



CLAUDIO LORENZO HATTEO

